



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 1/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Seykos” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, rr. “28 Nëntori”, përfaqësuar nga avokati Labinot Murati, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni” pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E. P., për shkak të anulimit të Konkluzionit PSh.nr.269/14 të datës 11.08.2014 dhe Vendimit PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014, pas shqyrtimit kryesor publik në rigjykim të mbajtur me datë 08.09.2023, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe në prezencë përfaqësuesit të autorizuar të paditurit, me datë 25.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Seykos” Sh.P.K. kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, ashtu që ANULOHET Konkluzioni PSh.nr.269/14 i datës 11.08.2014 dhe Vendimi PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014 i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit.
- II. Ky Aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- III. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Seykos” Sh.p.k. për pjesën me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit ti kompensoj dëmin material i shkaktuar në formën e fitimit të humbur shumë prej 147,843.87€ dhe në formën e dëmit real shumë prej 3,860€ të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga paraqitja e padisë datë 20.06.2014 e deri në përmbushjen përfundimtare.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi “Seykos” Sh.p.k., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e konkluzionit PSh.nr.269/14 të datës 11.08.2014 dhe Vendimit PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014 të Organit

Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) si të kundërligjshëm, me arsyetimin se paditësi si operator ekonomik dy herë radhazi me të drejtë është shpallur fitues i aktivitetit të prokurimit “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111 andaj, jo ligjshmëria e vendimit PSh.nr.151/14 i datës 26.06.2014 vërtetohet me faktin se me urdhëresën e datës 16.07.2014, i padituri OSHP e ka urdhëruar Autoritetin Kontraktues (AK) – Agjencinë Qendrore të Prokurimit ta anuloj prapë vendimin e marrë, dhe të respektoj të gjitha rekomandimet e dhëna nga OSHP që të bëjë njoftim për dhënie të kontratës për OE “Toni” Sh.P.K, andaj i padituri ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së për arsye se operatori ekonomik “Toni” Sh.P.K nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit për çmim më të lirë dhe nuk ka plotësuar kushtet mbi mundësinë teknike të kërkuar në pikën 9.1 dhe 9.2 për autorizim nga prodhuesi. Po ashtu ka theksuar se i padituri me Konkluzionin i kontestuar PSh.nr.269/14 të datës 11.08.2014 sipas të cilës i ka hedhur poshtë ankesën paditësit përmban vërtetim të gabuar të gjendjes faktike pasi që paditësi ka ofruar si dëshmi autorizimin e prodhuesit dhe garancionin e prodhuesit për produktet ‘Natrium Hypochlorite’ dhe ‘Gas Chlorine’. Tutje ka shtuar që paditësi ka ofruar si dëshmi dokumentin e lëshuar nga KRPP që konfirmon se autorizimi nga prodhuesi konsiderohet valid. Paditësi ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe të anuloj vendimin dhe konkluzionin e OSHP-së si dhe të bëjë kompensimin e dëmit. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka qëndruar në tërësi pranë padisë, pas pranimit të ekspertizës së ekspertit rreth vlerësimit nëse autorizimi i prodhuesit i dorëzuar nga operatori ekonomik “Seykos” Sh.P.K përmbush kërkesat nga dosja e tenderit në aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë, dhe pas kërkesëpadisë së precizuar sipas shumës së përcaktuar pas pranimit të ekspertizës financiare të ekspertit dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se i padituri është përgjegjës për dëmin të cilin paditësi e ka pësuar për shkak të mosdhënies së kontratës sipas tenderit “Furnizim me kemikate – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. të prokurimit AQP-AK 14-006-111. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet vendimi PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014 dhe konkluzioni PSh.nr.269/14 të datës 11.08.2014 dhe të detyrohet i padituri OSHP që paditësit t’ia kompensoj dëmin e pësuar dhe atë në emër fitimit të humbur shumë prej 260,494.84€ me kamatë ligjore 8% në vit.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i Panelit Shqyrtues të OSHP-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj padinë e paditësit si të pabazuar pasi që i njëjti është konstatuar si i papërgjegjshëm me vendimin PSH.nr.151/14 duke mos plotësuar kërkesën e AK-së, përkatësisht piken 9.1 të FTD-së ku kërkohet autorizim nga prodhuesi për dy produktet kimike. Nga konstatimi i ekspertit të caktuar nga i padituri është vërtetuar që paditësi nuk e ka

sjell autorizimin për prodhimin e produktit kimik ‘Natrium Hypochlorite’, andaj paditësi i rekomanduar për dhënien të kontratës në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kemikate – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. të prokurimit AQP-AK 14-006-111 ka qenë i papërgjegjshëm, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia e paditësit si e pa themeltë dhe të mbetet në fuqi vendimi i OSHP-së. Në seancë të shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar pranë përgjigjes në padi dhe kundërshton ekspertizën e ekspertit Ilaz Pepaj me arsyetimin se OSHP ka kthyer lëndën në rivlerësim AK-së ashtu që aktiviteti i prokurimit të vazhdoj në fazën ku ka mbetur dhe nuk ka vendosur me vendim përfundimtar bazuar në nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”* Gjykatës i ka propozuar që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe të lërë në fuqi vendimet e të paditurës si të ligjshëm.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr. 2546/2014 të datës 08.11.2019 ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit “Seykos” Sh.P.K., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr. 151/14 të datës 27.06.2014 i nxjerrë nga i padituri OSHP.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së paditësit, me Aktvendimin AA.nr. 131/2020, të datës 22.09.2021 ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit Seykos Sh.p.k. dhe ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, A.nr. 2546/2014 të datës 08.11.2019 dhe lëndën e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike pasi që e njëjta vetëm se ju ka referuar vendimit të nxjerrë nga i padituri dhe arsyetimit në të pa i vlerësuar dhe arsyetuar pretendimet e palës paditëse lidhur me procedurën e zhvilluar pranë të paditurit nga e cila edhe ka ardhur vendimi përfundimtar në këtë procedurë gjyqësore dhe se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar faktin se e paditura a e ka zbatuar drejtë dispozitën e nenit 7 par.1, nenit 13, nenit 9 par. 1, nenit 56 par.1 pika 1.1. dhe 1.2, nenit 59, nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në rigjykim, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Ekspertiza e prokurimit publik e hartuar prej Ekspertit A. M. e punuar me datë

22.02.2023, Përgjigje e shkresës nr.130/2014 datë 18.07.2014, Ankesë nr.151/14 datë 30.05.2014, Ekspertizë lidhur me ankesën nr.151/14 e datës 23.06.2014, Vendim PSH.nr.151/14 i datës 27.06.2014, Ankesë nr.237/14 datë 14.07.2014, Urdhëresë nr.237/14 datë 17.07.2014, Njoftim 237/14 datë 22.07.2014, Ankesë nr.269/14 datë 31.07.2014, Raporti i Ekspertit Shqyrtues nr.269/14 07.08.2014, Konkluzion Psh.nr.269/14 i datës 11.08.2014, Kontratë kornizë në mes të APP dhe Sey Kos ShPK për aktivitetin e prokurimit nr.237/11/002/111 e nënshkruar me datë 03.05.2011, Kontratë kornizë në mes të APP dhe Sey Kos ShPK për aktivitetin e prokurimit nr.237/09/004/111 e nënshkruar me datë 31.03.2009, Përgjigje nr.269/14 datë 23.10.2014, Authorization of manufacturer datë 09.05.2014, Quality certificate, Quality certificate datë 04.03.2014, Certifikatë nr.16-608 e datës 18.07.2013 e vlefshme deri më 17.07.2016, Autorizim i datës 09.04.2014, Guarantee letter datë 09.04.2014, Certifikatë e analizave datë 24.02.2014, Oferta e OE Sey Kos ShPK, Kontrata publike kornizë e lidhur në mes të AQP dhe NTP Toni për aktivitetin e prokurimit nr. AQP-AK-14-006-111, Letra standarde për tenderuesin e eliminuar datë 21.07.2014, Letra standarde për tenderuesin e suksesshëm datë 21.07.2014, Raport i rivlerësimit të tenderëve i datës 21.07.2014, Raporti i vlerësimit i datës 04.07.2014, Procesverbal i hapjes së tenderit i datës 12.05.2014, Dosja e tenderit të aktivitetit të prokurimit nr.AQP-AK-14-006-111 me titull “Furnizimi me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije”, ekspertiza nga lëmia e prokurimit e hartuar nga Eksperti Ilaz Pepaj, e punuar me datë 12.05.2023, ekspertiza nga lëmia financiare e hartuar nga Ekspertja Albulena Salihu e datës 19.07.2023.

Gjykata në rigjykim vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata konstatoi se me Konkluzionin PSh.nr. 269/14 të datës 11.08.2014, Paneli Shqyrtues i Prokurimit në pikën I të dispozitivit ka hedhur poshtë si të pa bazuar ankesën e OE “Seykos” Sh.P.K të datës 31.07.2014 lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Furnizimi me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. të prokurimit nr.AQP-AK-14-006-111 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit, në pikën II ka lejuar Autoritetin Kontraktues që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë. Gjithashtu në fund të vendimit ka dhënë këshillën juridike që palët e pakënaqura në afat prej 30 ditëve mund ti drejtohen Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative.

Po ashtu gjykata ka konstatuar se paraprakisht, me Vendimin PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014 Paneli Shqyrtues i Prokurimit në pikën I të dispozitivit kishte aprovuar ankesën e operatorit ekonomik “Toni” Sh.P.K të datës 30.05.2014 si të bazuar në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. të prokurimit nr.AQP-AK-14-006-111 të iniciuar nga AK – Agjencia Qendrore e Prokurimit, në pikën II kishte anuluar vendimin e AK dhe lëndën e kishte kthyer në rivlerësim me konstatimin e OE “Seykos” është i papërgjegjshëm.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i cili përcakton se: *“3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative”* si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”*

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit sepse i padituri në mënyrë të gabuar ka konstatuar gjendjen faktike në procedurë administrative dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat ligjore të aplikueshme lidhur me Ligjin për Prokurimin Publik.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Dosja e Tenderit të Aktivitetit të Prokurimit nr.AQP-AK-14-006-111 me titull “Furnizimi me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije”, gjykata ka konstatuar se AK – Agjencia Qendrore e Prokurimit ka përgatitur dosjen e tenderit për kontratën publike kornizë – furnizim me një operator ekonomik me datë 28.03.2014 me titull “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111, i ndarë në pjesën që përmbajnë procedurat e tenderimit që përmbajnë udhëzime për përgatitjen e tenderit, draft kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t’i pranoj tenderuesi që merr kontratën dhe formularin e tenderit që përfshinë dokumentet të cilat duhet t’i paraqesin tenderuesit.

Nga oferta e OE “Seykos” Sh.P.K, gjykata ka konstatuar se paditësi ka dorëzuar ofertën e tij lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për

pije” me nr. AQP-AK-14-006-111 me datë 12.05.2014 bashkangjitur me dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit.

Nga Procesverbali i Hapjes së Tenderit i datës 12.05.2014, gjykata ka konstatuar se me datën 12.05.2014 në orën 14:30 është hartuar procesverbali lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111, përmes të cilit është evidentuar numri i tenderëve të pranuar së bashku me tenderuesit që kanë qenë pjesëmarrës në këtë aktivitet dhe çmimet përmes të cilit kanë ofertuar, ku OE “Toni” Sh.P.K ka ofertuar me çmimin në vlerë prej 439,028.00€, ndërsa paditësi ka ofertuar me çmimin në vlerën prej 415,458.00€ si OE në këtë tender, po ashtu është evidentuar edhe prezenca e anëtarëve të komisionit të hapjes së këtij tenderi.

Nga Ankesa nr.151/14 e datës 30.05.2014, gjykata ka konstatuar se “Toni” Sh.P.K ka ushtruar ankesë me datë 30.05.2014 tek i padituri ndaj rekomandimit të Autoritetit Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit për dhënien e kontratës operatorit ekonomik Seykos Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111 me arsyetimin se gjatë këtij aktiviteti të prokurimit AK ka bërë shkelje për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të pikës 9.1 të FDT-së lidhur me autorizimin e prodhuesit.

Nga Ekspertiza lidhur me ankesën nr.151/14 e datës 23.06.2014, gjykata ka konstatuar se OSHP pas pranimit të ankesës nr.151/14 të operatorit ekonomik “Toni” Sh.P.K ka caktuar ekspertin shqyrtues për vlerësimin e pretendimeve ankimore të OE “Toni” Sh.P.K ku sipas raportit të ekspertizës të datës 23.06.2023 eksperti ka konstatuar se AK nuk ka respektuar kërkesat të pikës 9.1 të FDT-së dhe i ka propozuar panelit shqyrtues që të aprovoj ankesën e OE “Toni” Sh.P.K dhe të anuloj vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Nga Raporti i Vlerësimit të tenderëve i datës 04.07.2014, gjykata ka konstatuar se AK – Agjencia Qendrore e Prokurimit me datë 04.07.2014 ka përgatitur raportin e vlerësimit të tenderit “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111, përmes të cilit komisioni i vlerësimit rekomandon paditësin si tenderues i suksesshëm për dhënie të kontratës dhe përmes dokumentit lidhur me kërkesat e pranueshmërisë të nënshkruar nga zyrtari i prokurimit me datë 04.07.2014 paditësi është shpallur fitues i tenderit.

Nga Ankesa nr.237/14 e datës 14.07.2014, gjykata ka konstatuar se “Toni” Sh.P.K ka ushtruar ankesë me datë 14.07.2014 tek i padituri ndaj AK për mosrespektim të vendimit të OSHP-së

PSh.nr. 151/14 të datës 26.06.2014 për anulim të vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111.

Nga Urdhëresa nr.237/14 e datës 17.07.2014, e nxjerrë nga OSHP me 16.07.2014, gjykata konstatoi se i padituri përmes kësaj urdhërese ka kërkuar nga AK – Agjencia Qendrore e Prokurimit që të zbatoj vendimin e OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111 dhe të anuloj vendimin për dhënie të kontratës të datës 12.12.2012 dhe ka konstatuar se vendimi i OSHP PSh.nr. 151/14 është vendim përfundimtar apo i formës së prerë për këtë aktivitet të prokurimit “*andaj Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave t’i respektojë në tërësi të gjitha rekomandimet e dhëna nga Paneli Shqyrtues*”.

Nga Përgjigje e Shkresës nr.130/2014 e datës 18.07.2014, gjykata ka konstatuar se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i është përgjigjur paditësit lidhur me kërkesën nr. 130 të datës 18.07.2014, dhe ka njoftuar paditësin se KRPP konsideron se autorizimi nga prodhuesi mund të konsiderohet si valid dhe nëse AK dyshon në validitetin e autorizimit mund të kontaktojë prodhuesin i cili ka lëshuar autorizimin për vërtetim të tij.

Nga Raporti i Rivlerësimit të tenderëve i datës 21.07.2014, gjykata ka konstatuar se AK sipas urdhëresës së OSHP-së nr.237/14 të datës 17.07.2014 ka bërë rivlerësimin e tenderit me titull “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111 dhe sipas procesverbalit për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve komisioni për vlerësim konstaton se operatori ekonomik “Seykos” Sh.P.K është i përgjegjshëm dhe oferta plotëson kriterin çmimi më i lirë i kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, mirëpo shpall operator të suksesshëm OE “Toni” Sh.P.K për arsye se urdhëresa e OSHP-së nr.237/14 është e formës së prerë.

Nga Letra Standarde për Tenderuesin e Suksesshëm e datës 21.07.2014, gjykata ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në bazë të urdhëresës nr.237/14 të OSHP-së të datës 17.07.2014 ka shpallur tenderues të suksesshëm operatorin ekonomik “Toni” Sh.P.K.

Nga Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar e datës 21.07.2014, gjykata ka konstatuar se Agjencia Qendrore e Prokurimit me anë të kësaj shkrese ka njoftuar operatorin ekonomik - paditësin që kanë eliminuar ofertën e tyre nga aktiviteti i prokurimit të cekur më lartë bazuar në urdhëresën nr.237/14 të OSHP-së të datës 17.07.2014.

Nga Kontrata Publike Kornizë e lidhur në mes të AQP dhe “Toni” Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit nr. AQP-AK-14-006-111, gjykata ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit ka nënshkruar kontratën kornizë publike nr. 06/2014 me furnizuesin “Toni” Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111.

Nga Njoftimi nr. 237/14 e datës 22.07.2014, gjykata ka konstatuar se OSHP ka dhënë njoftim me datën 22.07.2014 ku ka njoftuar Agjencinë Qendrore të Prokurimit se nuk e pranon raportin për rivlerësim me nr. të protokollit 237/23 të datës 22.07.2017 për arsye se është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe i ka rekomanduar AK-së që të bëjë përsëri rishqyrtim të rivlerësimit.

Nga Ankesa nr.269/14 e datës 31.07.2014, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 31.07.2014 ka parashtruar ankesë tek i padituri kundër njoftimit për dhënie të kontratës operatorit ekonomik “Toni” Sh.P.K të dhënë nga AK – Agjencia Qendrore e Prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111.

Nga Raporti i Ekspertit Shqyrtues nr.269/14 i datës 07.08.2014, gjykata ka konstatuar se i padituri pas pranimit të ankesës së paditësit ka caktuar ekspert për vlerësimin e pretendimeve të tij. Eksperti ka hartuar raportin nga ekspertiza e bërë në lidhje me ankesën e paditësit me nr. 269/14 lidhur me aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë. Eksperti duke u mbështetur në ekspertizën e datës 23.06.2014 ka konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit pasi që operatori ekonomik “Toni” Sh.P.K ka plotësuar kriteret e kërkuara nga dosja e tenderit lidhur me pikën 9.1 të FDT-së. Tutje thekson se tenderi nuk ka kufizuar ofertuesit ndërkombëtar dhe autorizimi i OE “Toni” Sh.P.K ka qenë në gjuhën angleze.

Nga Përgjigje nr. 269/14 e datës 23.10.2014, gjykata ka konstatuar se OSHP me datë 23.10.2014 ka refuzuar kërkesën e operatorit ekonomik “Seykos” Sh.P.K të datës 16.10.2014 lidhur me ndalimin i ekzekutimit të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me kemikate – klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. prokurimi AQP-14-006-11, me arsyetimin se OSHP nuk mund të ndërmarr veprime nga kërkesa e paditësit derisa nuk merret vendimi përfundimtar nga gjykata.

Nga Ekspertiza nga lëmia e prokurimit e hartuar nga Eksperti I. P., e punuar me datë 12.05.2023, gjykata ka konstatuar se Eksperti ka hartuar ekspertizën pas vlerësimit të dokumenteve të caktuara nga shkresat e lëndës duke vlerësuar nëse autorizimi i prodhuesit i

dorëzuar nga paditësi përmbush kërkesat nga dosja e tenderit në aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë. Eksperti ka konstatuar se autorizimi i paditësit e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe oferta është e përgjegjshme. Sipas ekspertizës së ekspertit paditësi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit në dokumentin e dhënë nga Kompania Zupa Komerc D.o.o i cili shpreh se *autorizohet OE Seykos Sh.P.K për të prezentuar produktet e kompanisë sonë për tenderin "Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit të pijshëm*. Eksperti thekson se konform nenit 59 par. 2 të LPP-së i padituri ka mundur të kërkoj sqarime lidhur me autorizimin për produktet 'Natrium Hypochlorite' dhe 'Gas Chlorine'. Gjithashtu ka kontestuar se paditësi ka dorëzuar deklaratë garancioni të dhënë nga Zupa Komerc D.o.o e cila konfirmon se Zupa Komerc D.o.o është prodhues i produkteve kimike të cekura më lartë dhe siguron që këto produkte plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Ndërlidhur me këtë në shkresa të lëndës janë vlerësuar edhe dokumentet ku Kompania Zupa Komerc D.o.o kishte bërë furnizimin me këto produkte kimike në kontrata paraprake të paditësit me AK, të cilat janë dëshmuar me kontrata, fatura të furnizimit dhe dëshmi doganore dhe interpretimi i KRPP-së i datës 18.07.2014 sipas të cilit autorizimi i dorëzuar nga paditësi është valid.

Nga Authorization of Manufacturer e datës 09.05.2014, gjykata ka konstatuar se "B-Kontakt" OOD, me seli në Byala, Bullgari, prodhues i kemikaleve për mirëmbajtje të ujit të pijshëm, i ka dërguar AK - Agjencionit Qendror të Prokurimit dokumentin me titull "Autorizim i prodhuesit" i shkruar në gjuhën angleze dhe i nënshkruar, lidhur me autorizimin e lëshuar për operatorin ekonomik "Toni" Sh.P.K për pjesëmarrjen në tender "Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije" me nr. AQP-AK-14-006-111 për përdorimin e produkteve kimike – 'Natrium Hypochlorite' dhe 'Gas Chlorine'.

Nga Quality Certificate, gjykata ka konstatuar se "B-Kontakt" OOD ka dhënë certifikatë për OE "Toni" Sh.P.K për kualitetin për produkteve kimike – klor i lëngshëm, e shkruar në gjuhën angleze.

Nga Quality Certificate e datës 04.03.2014, gjykata ka konstatuar se "B-Kontakt" OOD ka dhënë certifikatë për OE "Toni" nr.18 për kualitetin e produkteve kimike – 'Natrium Hypochlorite' e lëshuar me datë 04.03.2014 dhe e shkruar në gjuhën angleze.

Nga Certificate nr.16-608 e datës 18.07.2013 e vlefshme deri me datë 17.07.2016, gjykata ka konstatuar se "B-Kontakt" OOD ka dhënë certifikatë për "Toni" Sh.P.K me nr.16-608 me datë 18.07.2013 lidhur me certifikimin e prodhimit dhe tregtimit të klorit dhe produkteve që përmbajnë klor, e vlefshme deri me datë 17.07.2016 dhe e shkruar në gjuhën angleze.

Nga Autorizimi i datës 09.04.2014, gjykata ka konstatuar se Zupa Komerc D.o.o me seli në Krusevac, Republika e Serbisë, ka dhënë për “Seykos” Sh.P.K autorizim të prodhuesit për furnizim të produkteve të klorit për trajtimin e ujit të pijshëm në tenderin “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111.

Nga Guarantee Letër e datës 09.04.2014, gjykata ka konstatuar se Zupa Komerc D.o.o përmes dokumentit të datës 09.04.2014 ka njoftuar Agjencinë Qendrore të Prokurimit dhe palët e tjera të përfshira duke siguruar se produktet kimike e prodhuara të klorit dhe ‘Natrium Hypochlorite’ plotësojnë kushtet e kërkuara në tenderin “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111.

Nga Certifikata e Analizave e datës 24.02.2014, gjykata ka konstatuar se Zupa Komerc D.o.o ka paraqitur analizat rreth kualitetin të klorit të bëra me datë 24.02.2014.

Nga Ekspertiza nga lëmia financiare e hartuar nga Ekspertja A. S. e datës 19.07.2023, gjykata ka konstatuar se eksperti financiar ka bërë përlllogaritjen e dëmit real të paditësit duke u bazuar në dokumentet e caktuara dhe raportet e kontabël të paditësit për periudhën e kontraktimit, sipas të cilave ka rezultuar se paditësi ka pësuar dëm material në formën e fitimit të humbur shumë prej 147,843.87€ dhe dëm material real në shumë prej 3,860.00€ ndërsa kamata ligjore prej 8% e kalkuluar nga data e paraqitjes së padisë e deri me datë 15.06.2023 për fitimin e humbur ka rezultuar 106,285.57€ dhe për dëmin material real në shumë prej 2,505.40€. Eksperti në seancë gjyqësore ka qëndruar pranë ekspertizës dhe ka shprehur se tek dëmi real që ka konstatuar është bazuar në faturat, taksat e paguara dhe pagesat për ekspertë. Tutje ka shtuar se ka bërë kalkulim të ndarë të kamatës për fitimin e humbur në vlerë prej 106,285.57€ dhe kalkulim të kamatës për dëmin real që është 2,505.40€ dhe pas kalkulimit të dy shumave paraqet vlerën totale të kamatës.

Gjykata, ekspertizën e prokurimit publik e hartuar nga Ekspertit A. M. e punuar me datë 22.02.2023 nuk e ka vlerësuar pasi që me Aktvendim të datës 03.04.2023 ka aprovuar kërkesën e përfaqësuesit të paditësit në seancë të shqyrtimit kryesor për përjashtim të ekspertit nga detyra e ekspertimit.

Nga Kontrata Kornizë në mes të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Seykos Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit nr. 237/11/002/111 e nënshkruar me datë 03.05.2011, gjykata ka konstatuar se APP si autoritet kontraktues dhe operatori ekonomik “Seykos” Sh.P.K si kontraktues kanë nënshkruar kontratën kornizë për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim

me kemikate – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. të prokurimit 237/11/002/111 me datë 03.05.2011.

Nga Kontrata Kornizë në mes të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Seykos Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit nr.237/09/004/111 e nënshkruar me datë 31.03.2011, gjykata ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues – APP dhe kontraktuesi “Seykos” Sh.P.K me datë 31.03.2011 kanë nënshkruar kontratën kornizë me titull “Furnizim me kemikate për 7 kompanitë rajonale për ujë dhe kanalizim” me nr. të prokurimit 237/09/004/111.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri nuk ka vepruar drejtë kur ka anuluar vendimin e AK për dhënie të kontratës lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Furnizim me kemikate – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111, pasi që i padituri ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën faktike dhe vendimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 59 par.4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. ...”* Gjykata vlerëson se në rastin konkret paditësi ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe se kriteri për të cilin i padituri ka anuluar vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim në dëm të paditurit ka qenë vërtetim i gabuar i gjendjes faktike dhe nuk është vlerësuar drejtë nga i padituri.

Nga provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës gjykata ka gjetur se me Autorizimin dhe Guarantee Letër të datës 09.04.2014 është vërtetuar se paditësi “Seykos” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ka ofruar autorizimin nga prodhuesi i autorizuar për të dy produktet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Gjykata po ashtu iu referua nenin 60 par. 1, pika 1.1 të LPP-së i më te cilin përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët”*, ashtu që gjykata vlerëson se me dosjen e tenderit por edhe me dispozitat e LPP-së përfundimisht operatori ekonomik “Seykos” Sh.P.K. – këtu paditësi, ka qenë ofertues i përgjegjshëm me çmim më të ultë në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kemikalje – Klor për përpunimin e ujit për pije” me nr. AQP-AK-14-006-111.

Gjykata vlerëson i padituri ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 7 par.1 dhe 2 të LPP-së pasi që nuk i ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë, përkatësisht për paditësin nuk ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm

në kohën e vlerësimit dhe se një kriter i tillë ka reduktuar apo eliminuar konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik, dhe me nenin 13 par. 4 të LPP-së që përcakton se *“4. Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.”*

Gjykata vlerëson se nga gjendja faktike e konstatuar në këtë procedurë, i padituri me Vendimin PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014, gabimisht paditësin e ka trajtuar si të papërgjegjshëm dhe e ka obliguar Autoritetin Kontraktues që për kontratë të rekomandojë operatorin ekonomik i cili ka qenë me çmim më të lartë se sa paditësi, e pastaj me Konkluzionin PSh.nr.269/14 të datës 11.08.2014 kanë hedhur poshtë ankesën e paditësit pasi që kanë trajtuar se pretendimet e paditës janë çështje e gjykuar.

Gjykata lidhur me pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi në kuptim të nenit 46 par.4 të LKA-së i cili përcakton se: *“4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.”* ashtu që gjykata vendosi që të anuloj Konkluzionin PSh.nr.269/14 të datës 11.08.2014 dhe Vendimin PSh.nr.151/14 të datës 26.06.2014 pasi që tashmë ky aktivitet i prokurimit ka përfunduar dhe kthimi në rivendosje do ishte i pa efekt lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 119 par.3 të LPP-së i cili përcakton se: *“3. Nëse pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e tij të mëparshme që i është dorëzuar OSHP është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata lëshon një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marrë nga OSHP, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstrojë se ai është dëmtuar nga veprimi ose mos-veprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjykata gjithashtu mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues që të ia paguajë parashtruesit të ankesës kompensimin adekuat.”* Duke qenë se në këtë rast, si i paditur ka qenë vetëm Organi Shqyrtues i Prokurimit, gjykata ka vlerësuar se nuk ka mundur vlerësoj kërkesën për kompensimin e dëmit që ka pësuar paditësi, pasi që dispozita e lartcekur përcakton në mënyrë të qartë që gjykata mund të obligojë vetëm autoritetin kontraktues kompensimin e dëmit ndaj operatorit ekonomik, ndërsa Organi Shqyrtues i Prokurimit pavarësisht veprimeve të ndërmarra dhe pasojës së krijuar nga këto veprime, nuk ka legjitimitet real pasiv për kompensimin e dëmit ndaj operatorëve ekonomik.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr. 1/22, datë 25.09.2023

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.